



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 563/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada - Glllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e parashtruar nga Abedin Idrizaj, Kordinator i degës së subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Istog, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.11.2017, mori këtë

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Abedin Idrizaj, Kordinator i degës së subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Istog.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 01.11.2017, ka pranuar një ankesë nga Abedin Idrizaj, Kordinator i degës së subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Istog, në të cilën ka pretenduar se në rezultatet përfundimtare, për Kryetar të Komunave, mungojnë votat e familjarëve të kandidatit për Kryetar të Komunës së Istogut nga subjekti politik PDK. Sipas parashtruesit të ankesës, kjo ka ndodhur pasi që ka pasur parregullsi të shumta gjatë numërimit të votave në këto vendvotime: në Istog: 0601C/1R, 0602C/2R, 0603C/3R, në Banjë: 0602C/1R, 0602C/2R, 0602C/3R, 0602C/4R, 0602C/5R, 0602C/6R, 0602C/7D, në Gurrakoc 0604C/1R, 0604C/2R, 0604C/04R, 0604C/5R, në Zallq: 0605C/1R, 0605C/2R, 0605C/3R, në Sinaj: 0611C/1D, 0620C/1R, 0620C/2R, 0620C/3R, në Vrellë: 0606C/2R, 0606C/1R, 0606C/6D, në UÇK 0613C/1R, 0613C/2D, 0608C/1R, 0608C/2D.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par. 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet në ankesën e parashtruar, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë vendosjes për një ankesë i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në

ankesë dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i ankesës, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon ankesën si të pabazuar.

Paneli vlerëson se pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se me rastin e shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, për zgjedhjet lokale të datës 22.10.2017 për Kryetar të Komunës së Istogut, ka pasur parregullësi, janë të pabazuara në ligj, siç kërkohen me nenin 117 par 3, nenin 118 të LZP-së dhe nenin 5 par.7 pika c) e Rregullës Nr.02/2015 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.563/2017 me datën 02.11.2017.



Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.